

REPUBLIKA E KOSOVËS
 Komuna e Prizrenit
 Kryetari i Komunës
 Nr. 01/011-28026
 Më 24.9.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për përkrahje financiare të disa ShKA-ve për vitin 2013, kryetari i Komunës më 24 shtator 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
 PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, i datës 17.9.2013, për lejimin e mjeteve për përkrahje financiare të disa ShKA-ve për vitin 2013, lidhur me ushtrimin e aktiviteteve të tyre, kështu që ShKA-të që përkrahen financiarisht janë:

- | | |
|--|-------------|
| 1. ShKA "Agimi"- Prizren me..... | 2000 €, |
| 2. AKV "Lidhja e Prizrenit" -Prizren me. | 2000 €, |
| 3. AAKV "Emin Duraku" -Zhuri me..... | 2000 €, |
| 4. ShKA "Muharrem dhe Xhevat Qena"-Romaja me... .. | 2000 €, |
| 5. ShKA "Dogru Yol"- Prizren me..... | 1500 €, |
| 6. ShKA "Podgorski Biseri" me | 1500, |
| 7. ShKA "Katarina Josipi" nga Zymi me | 1000 €, |
| 8. ShKA "Sarski Behar" me | 1000 €, |
| 9. ShKA "Durmish Asllano"-Prizren me | 1000 €, dhe |
| 10. ShKA "Mesk"- Prizren me..... | 1000 €. |

Gjithsej shuma e përgjithshme e mjeteve që lejohet në emër të përkrahjes financiare për ShKA-të e lartcekura është 15000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit



Kryetari i Komunës
 Prof. dr. Ramadan Muja

[Handwritten signature]

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-26161
Më 24.9.2013

Kryetari i Komunës, pas propozimit të Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e shpalljes së tenderit për rregullimin e kroit (Shatërvanit) në fshatin Zhur, mori këtë


KONKLuzion

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, i datës 19.9.2013 për lejimin e rregullimit të kroit (Shatërvanit) në fshatin Zhur, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-26161
Më 24.9.2013

Kryetari i Komunës, pas propozimit të Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e shpalljes së tenderit për hartimin e projektit dhe ndërtimin e Kullës Muze në fshatin Jeshkovë, mori këtë

KON KLUZION

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, i datës 19.9.2013 për lejimin e hartimit të projektit të ndërtimit të Kullës Muze në fshatin Jeshkovë dhe ndërtimin e kësaj kulle pas hartimit të projektit përkatës, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Maja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-26161
Më 24.9.2013

Kryetari i Komunës, pas propozimit të Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, për lejimin e shpalljes së tenderit për mirëmbajtjen e Web faqes-Prizreni 360 shkallë, mori këtë ,

KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, i datës 19.9.2013 për lejimin e mirëmbajtjes së Web faqes-Prizreni 360 shkallë, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-28027
Më 24.9.2013

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Nënkyetarit të Komunës, për lejimin e udhëtimit zyrtar për në Durrës dhe pagesës së mëditjeve për pesë (5), zyrtar komunal, kryetari i Komunës, më 24 shtator 2013, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

Miratohet propozimi i Nënkyetarit të Komunës, i datës 16.9.2013 për lejimin e udhëtimit zyrtar të Ruzhdi Rexhës, nënkryetari i komunës, Samir Hoxhës, drejtor i DZhET, Ramadan Tafallari, Galip Belallari dhe Shpresa Osmanollajt, zyrtar komunal, për në Durrës të Republikës së Shqipërisë, me qëllim të pjesëmarrjes në Konferencën rajonale e cila realizohet në kuadër të projektit "Rrjeti i planeve të Biodiversitetit në Ballkanin Perëndimor". Konferenca do të mbahen nga data 25 shtator deri me 26 shtator 2013, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve, për të lartcekurit.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve.

Neni 3


Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Nënkyetari i Komunës dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4,

Me këtë Vendim të njoftohen: Nënkyetari i Komunës, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, të lartcekurit, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-26161
Më 24.9.2013

Kryetari i Komunës, pas propozimit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për lejimin e shpalljes së tenderit për ngritjen e serrave me participim me fermerët, mori këtë

KON KL U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i datës 10.9.2013, për lejimin e ngritjes së serrave me participim fermerët, kështu që, për këtë qëllim, lejohet shpallja e tenderit për ngritjen e:


- a. 1 (një) serre me 500 m²
- b. 10 (dhjetë) serrave me nga 240 m² dhe
- c. 8 (tetë) serrave me nga 144 m².

Përfituesit e këtij projekti (fermerët) do të participojnë me 25 % të vlerës së serrës ndërsa Komuna me 75 % të vlerës përkatëse.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-28029
Më 24.9.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Zyrës për Komunitete dhe Kthim, për lejmimin e mjeteve financiare për shtrimin e një dreke për mysafirët të cilët do të marrin pjesë në Konferencën lidhur me ultrasonografinë për gjinekologji dhe neonatologji në Kosovë, kryetari i Komunës, më 24 shtator 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, bazuar në kërkesën e drejtoreshës së organizatës "Of Ian Donald School-Branch", për lejmimin e mjeteve financiare për shtrimin e një dreke për mysafirët ndërkombëtar të cilët do të marrin pjesë në Konferencën lidhur me ultrasonografinë për gjinekologji dhe neonatologji në Kosovë, që do të mbahet me datën 1 tetor 2013 në Prishtinë, kështu që për këtë qëllim, lejohen mjetet e nevojshme financiare në shumën 300 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i mallrave dhe shërbimeve dhe subvencioneve të Zyrës për Komunitete dhe Kthim.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4

Me këtë Vendim të njoftohen: Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-28032
Më 24.9.2013

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për Gyler Krasniqin, kryetari i Komunës, më 24 shtator 2013, miratoi këtë:

V E N D I M
PËR LEJIMIN E MJETEVE NGA BUXHETI

Neni 1

Miratohet propozimi i Drejtorisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për Gyler Krasniqin (bashkëshortja e Nevzat Krasniqit i cili ka humbur jetën tragjiksht), lidhur mbulimin e shpenzimeve të varrimit të të ndjerit dhe për shpenzime tjera elementare, kështu që, për këtë qëllim lejohen mjetet në lartësi prej 1000 €.

Neni 2

Shuma e lejuar, e përshkruar si në nenin 1 të këtij Vendimi do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe i mallrave e shërbimeve të Komunës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

Neni 4,

Me këtë Vendim të njoftohen: Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, e lartcekura, si dhe arkivi.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.



Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja